



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 63/13prot.

Datë 09.02.2026

V E N D I M
Nr. 221/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.02.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 146/2026, datë 27.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-70081-11-25-2025, me objekt: “Blerje pjese kembimi kazanesh”, me fond limit 4,284,900.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.12.2025 nga autoriteti kontraktor, ECO Tirana sha.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me NIPT M113130290 dhe adresë: Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi rezidencial “Magnet”, Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017 , Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** ECO Tirana sha me adresë Rruga “Don Bosko”, ish parku i autobusave, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Inply” SHPK me NIPT L51503032Q dhe adresë: Rruga Irfan Tomini, Godina 6-7, kati 1, ZK 8260, Nr. Pas. 1/395-N11, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen

e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 27.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.146/2026 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik, “Bajro Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-70081-11-25-2025, me objekt: “Blerje pjese kembimi kazanesh”, me fond limit 4,284,900.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.12.2025 nga autoriteti kontraktor, ECO Tirana sha .*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Inply” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim, duke e skualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK*
5. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 369/16 prot., datë 02.02.2026 protokolluar me tonën nr. 63/10 prot., datë 05.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.146/2026 datë 27.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-70081-11-25-2025, me objekt: “Blerje pjese kembimi kazanesh”, me fond limit 4,284,900.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.12.2025 nga autoriteti kontraktor, ECO Tirana sha, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 02.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 369/16 prot., datë 02.02.2026 protokolluar me tonën nr. 63/10 prot., datë 05.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.146/2026 datë 27.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-70081-11-25-2025, me objekt: “Blerje pjese kembimi kazanesh”, me fond limit 4,284,900.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar

me datë 10.12.2025 nga autoriteti kontraktor, ECO Tirana sha, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 02.02.2026.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.146/2026 datë 27.01.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.146/2026 datë 27.01.2026, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-70081-11-25-2025, me objekt: “Blerje pjese kembimi kazanesh”, me fond limit 4,284,900.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10.12.2025 nga autoriteti kontraktor, ECO Tirana sha.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

